



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 16.03.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“SHTESA E KRAHUT VERIOR, PROJEKTI PËR ZGJERIMIN E TERMINALIT TË
PASAGJERËVE TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA” DHE GODINA E RE E POLICISË,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË KRUIJË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Tirana International Airport” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtesa e krahut verior, projekti për zgjerimin e terminalit të pasagjerëve të Aeroportit “Nënë Tereza” dhe godina e re e policisë, me vendndodhje në Bashkinë Krujë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tirana International Airport” sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Krujë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

